

**Rregullore (BE) 2015/2120 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit
E 25 nëntor 2015**

Që përcakton masat në lidhje me një akses të lirë të Internetit dhe që modifikon Direktivën 2002/22/KE të shërbimit universal dhe të të drejtave të përdoruesve në fushën e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik dhe rregulloren (BE) nr. 531/2012 në lidhje me shërbimin roaming në rrjetet publike të komunikimeve mobile brenda Bashkimit Evropian

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton rregullat e përgjithshme për të garantuar një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të trafikut në furnizimin me shërbime aksesi në Internet si dhe me të drejtat e përdoruesve fundorë.
2. Kjo rregullore vendos një mekanizëm të ri çmimesh pakice për shërbimet roaming të rregulluara brenda Bashkimit Evropian me qëllim shfuqizimin e çmimeve të larta të shërbimit roaming me pakicë, pa shtrembëruar tregjet kombëtare dhe ato të vizituara.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje do të aplikohen përkufizimet e nenit 2 të Direktivës 2002/21/KE. Do të aplikohen, gjithashtu, edhe përkufizimet e mëposhtme:

1. “Ofrues i shërbimeve të komunikimeve elektronike për publikun”: një ndërmarrje që ofron rrjete publike të komunikimeve ose shërbime të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut;
2. “Shërbim i aksesit në Internet”: një shërbim i komunikimit elektronik në dispozicion të publikut, që ofron akses në Internet, pra lidhje për të gjitha pikat fundore të Internetit, pavarësisht nga teknologjia e rrjetit dhe nga pajisjet fundore të përdorura.

Neni 3

Mbrojtja e aksesit në një rrjet Interneti të hapur

1. Përdoruesit fundor kanë të drejtë të marrin informacione dhe përmbajtje dhe t’i shpërndajnë ato, si dhe të përdorin dhe ofrojnë aplikacione dhe shërbime, dhe të përdorin pajisje fundore sipas zgjedhjes së tyre, pavarësisht nga vendndodhja e përdoruesit fundor ose të ofruesit ose pavarësisht nga vendndodhja, origjina ose destinacioni i informacioneve, përmbajtjeve, aplikacioneve ose shërbimeve, nëpërmjet shërbimit të aksesit në internet. Përmbajtja e kësaj pike nuk ndikon tek legjislacioni i Bashkimit Evropian, ose tek legjislacioni kombëtar në përputhje me atë të Bashkimit Evropian, në lidhje me ligjshmërinë e përmbajtjeve, aplikacioneve ose shërbimeve.
2. Marrëveshjet midis ofruesve të shërbimeve të aksesit në Internet dhe përdoruesve fundorë mbi kushtet dhe karakteristikat tregtare dhe teknike të shërbimit të aksesit në Internet, të tilla si çmimi, volumi i të dhënave ose shpejtësia, si dhe praktikatat tregtare të aplikuara nga ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet nuk e kufizojnë ushtrimin e të drejtave të përdoruesve fundorë sipas pikës 1.
3. Ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet, gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve, e trajtojnë të gjithë trafikun në të njëjtën mënyrë, pa diskriminime, kufizime ose interferenca, dhe pavarësisht nga burimi dhe destinacioni, i përmbajtjes për të cilën patën akses dhe që u shpërnda, nga aplikacionet ose shërbimet e përdorura ose të ofruara, ose nga pajisjet fundore të përdorura.

Paragrafi i parë nuk i ndalon ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet të zbatojnë masa për menaxhimin e arsyeshëm të trafikut. Për tu përkufizuar si të arsyeshme, këto masa duhet të jenë

transparente, jo diskriminuese dhe proporcionale dhe nuk duhet të bazohen në konsiderata tregtare, por mbi kërkesa për cilësi teknike të shërbimit, objektivisht të ndryshme sipas kategorive specifike të trafikut. Këto masa nuk kontrollojnë përmbajtjen specifike dhe mbeten në fuqi për një periudhë e cila mund të konsiderohet e përshtatshme.

Ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet nuk zbatojnë masa për menaxhimin e trafikut që shkojnë përtej atyre të përcaktuara në paragrafin e dytë dhe, në veçanti, nuk bllokojnë, ngadalësojnë, alternojnë, limitojnë, interferojnë me, degradojnë ose diskriminojnë midis përmbajtjeve specifike, aplikacioneve ose shërbimeve, ose kategori specifike të tyre, përveç rasteve kur kjo është e nevojshme dhe vetëm për një kohë të përshtatshme, me qëllim:

- a) Përshtatjen me aktet ligjore të Bashkimit Evropian ose me legjislacionin kombëtar në përputhje me atë të Bashkimit Evropian, në të cilat ofruesi i shërbimeve të aksesit në Internet është subjekt, ose me masat e përshtatura me legjislacionin e Bashkimit Evropian të cilat vënë në zbatim këto akte të Bashkimit Evropian ose akte kombëtare, duke përfshirë vendimet gjyqësore ose të autoriteteve publike me kompetenca të tilla;
 - b) Ruajtjen e integritetit dhe sigurisë së rrjetit, të shërbimeve të ofruara nëpërmjet këtij rrjeti ose të pajiseve fundore të përdoruesve fundorë;
 - c) Parandalimin e një bllokimi të mundshëm të rrjetit ose lehtësimin e efekteve të një bllokimi të jashtëzakonshëm ose të përkohshëm të rrjetit, me kusht që kategoritë e barazvlefshme të trafikut të trajtohen në të njëjtën mënyrë.
4. Masat për menaxhimin e trafikut mund të përfshijnë përpunimin e të dhënave personale vetëm në rastin kur ky përpunim është i nevojshëm dhe në përpjestim me realizimin e objektivave të pikës 3. Ky përpunim kryhet në përputhje me direktivën 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Gjithashtu, masat e menaxhimit të trafikut duhet të jenë në përputhje me direktivën 2002/58/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.
5. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike për publikun, përfshirë dhe ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet, si dhe ofruesit e përmbajtjeve, aplikacioneve dhe shërbimeve janë të lirë të ofrojnë shërbime të ndryshme nga ato të aksesit në Internet të optimizuar për përmbajtje, aplikacione ose shërbime specifike ose kombinime të tyre, në rastet kur optimizimi është i nevojshëm për të pëmbushur kërkesat në lidhje me përmbajtjen, aplikacionet ose shërbimet për një nivel cilësie specifik.

Ofruesit e komunikimeve elektronike për publikun, duke përfshirë ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet, mund të ofrojnë ose lehtësojnë shërbime të tilla vetëm nëse kapaciteti i rrjetit është i mjaftueshëm për t'i ofruar ato si shtesë e të gjithë shërbimeve të aksesit në Internet të ofruar. Këto shërbime nuk mund të përdoren ose ofrohen si zëvendësim për shërbimet e aksesit në Internet dhe nuk duhet të jenë në dëm të disponueshmërisë ose cilësisë së përgjithshme të shërbimeve të aksesit në Internet për përdoruesit fundorë.

Neni 4

Masat e transparencës për të siguruar një akses të hapur në Internet

1. Ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet marrin masa në mënyrë të tillë që kontratat që përfshijnë shërbime të aksesit në Internet të saktësojnë minimalisht sa më poshtë vijon:
 - a) Informacion mbi impaktin e mundshëm që mund të kenë masat për menaxhimin e trafikut, të aplikuar nga ofruesi mbi cilësinë e shërbimeve të aksesit në Internet, mbi jetën private të përdoruesve fundor dhe mbi mbrojtjen e të dhënave të tyre personale;

- b) Një shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm të pasojave që mund të vijnë si rezultat i kufizimeve të vëllimit, shpejtësisë dhe të parametrave të tjerë të cilësisë së shërbimit, për shërbimet e aksesit në Internet dhe në veçanti mbi përdorimin e përmbajtjeve, aplikacioneve dhe shërbimeve;
- c) Një shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm të pasojave që shërbimet e cilësuara në pikën 5 të nenit 3, tek të cilat abonohet përdoruesi fundor, mund të kenë tek shërbimet e aksesit në Internet të ofruara për këtë përdorues;
- d) Një shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm të shpejtësisë së shërbimeve minimale të aksesit në Internet, të disponueshme zakonisht, të shpejtësisë maksimale dhe asaj të deklaruar për ngarkim dhe shkarkim për rastin e rrjeteve fikse ose të shpejtësisë maksimale të shërbimeve të aksesit në Internet të vlerësuar dhe të deklaruar për ngarkim dhe shkarkim për rastin e rrjeteve të lëvizshme, si dhe impaktin e mundshëm në rastin e devijimeve të mëdha të shpejtësive respektive për ngarkim dhe shkarkim të deklaruar në dokumentin e të drejtave të përdoruesve fundor të përmendura në pikën 1 të nenit 3;
- e) Një shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm të mjeteve ligjore në dispozicion të konsumatorit sipas legjislacionit kombëtar, në rast të mospërputhjes të vazhdueshme ose të përsëritur rregullisht, ndërmjet ofrimit të shërbimit aktual të aksesit në Internet në lidhje me shpejtësinë ose me parametra të tjerë të cilësisë së shërbimit dhe ofrimit të shërbimit të deklaruar në përputhje me shkronjat a) – d).

Informacionet e pikës 1 bëhen publike nga ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet.

2. Ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet parashikojnë procedura transparente, të thjeshta dhe eficiente për të trajtuar ankesat e përdoruesve fundor në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 3 dhe në pikën 1 të nenit aktual.
3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2 i shtohen atyre të parashikuara në direktivën 2002/22/KE dhe nuk pengojnë Vendet Anëtare të mbajnë ose të shtojnë kërkesa shtesë për monitorimin, informacionin dhe transparencën, përfshirë ato në lidhje me përmbajtjen, formën dhe llojin e informacionit të publikuar. Këto kërkesa janë në përputhje me rregulloren aktuale dhe me dispozitat përkatëse të direktivave 2002/21/KE dhe 2002/22/KE.
4. Çdo mospërputhje e vazhdueshme ose e përsëritur rregullisht, ndërmjet performancës aktuale të shërbimeve të aksesit në Internet në lidhje me shpejtësinë ose me parametrat e tjerë të cilësisë së shërbimeve dhe performancës së deklaruar nga ofruesi i shërbimeve të aksesit në Internet në përputhje me shkronjat a) – d) të pikës 1, kur faktet janë konstatuar nga një mekanizëm monitorimi i certifikuar nga autoriteti kombëtar rregullator, konsiderohet si moskonformitet i shërbimeve, dhe përbën shkak për ushtrimin e mjeteve ligjore në dispozicion të konsumatorit sipas legjislacionit kombëtar.

Kjo pikë zbatohet vetëm për kontratat e lidhura ose të rinovuara me efekt nga data 29 nëntor 2015.

Neni 5

Mbikëqyrja dhe zbatimi

1. Autoritetet kombëtare rregullatore monitorojnë nga afër dhe sigurojnë plotësimin e kërkesave të neneve 3 dhe 4, si dhe promovojnë disponibilitetin konstant për një akses në Internet në nivele cilësie në një hap me progresin teknologjik. Për këtë qëllim, autoritetet kombëtare rregullatore mund të vendosin kërkesa në lidhje me karakteristikat teknike, kërkesa minimale për cilësinë e shërbimit dhe masa të tjera të përshtatshme dhe të nevojshme për një ose më shumë ofrues të

shërbimeve të komunikimeve elektronike për publikun, përfshirë këtu edhe ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet.

Autoritetet kombëtare rregullatore publikojnë raporte vjetore për monitorimet e kryera dhe për rezultatet e këtyre monitorimeve dhe ja vënë në dispozicion këto raporte Komisionit dhe BEREC-ut.

2. Me kërkesë të autoritetit kombëtar rregullator, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike për publikun, përfshirë dhe ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet, vënë në dispozicion të këtij autoriteti informacione në lidhje me detyrimet e përcaktuara në nenet 3 dhe 4, në veçanti informacione në lidhje me menaxhimin e kapaciteteve të rrjetit dhe trafikut të tyre, dhe japin shpjegime mbi çdo masë të aplikuar për menaxhimin e trafikut. Ky informacion jepet në përputhje me kushtet dhe nivelin e detajimit të specifikuar nga autoriteti kombëtar rregullator.
3. Brenda datës 30 gusht 2016, me qëllim për të kontribuar në një aplikim sa më koherent të kësaj rregullore, BEREC, pas konsultimit me palët e interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, harton orientimet për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara nga autoritetet kombëtare rregullatore në përputhje me nenin aktual.
4. Ky nen nuk cënon detyrat e caktuara nga Vendet Anëtare për autoritetet kombëtare rregullatore ose autoriteteve të tjera kompetente, në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Neni 6

Sanksionet

Vendet Anëtare përcaktojnë rregullat në lidhje me sanksionet që do të vendosen në rast shkeljeje të neneve 3, 4 dhe 5 dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e tyre. Sanksionet e parashikuara duhet të jenë efektive, proporcionale dhe bindëse. Vendet Anëtare njoftojnë Komisionin për këto rregulla dhe masa brenda datës 30 prill 2016 dhe marrin masa menjëherë të bëjnë njoftimin në rast ndryshimi të mëtejshëm.

Neni 7

Ndryshimet e rregullores (BE) nr. 531/2012

Rregullorja (BE) nr. 531/2012 ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Tek neni 2, pika 2 ndryshohet si vijon:
 - a) Shkronjat i), l) dhe n) shfuqizohen;
 - b) Shtohen shkronjat në vijim:
 - “r) “çmimi kombëtar me pakicë”, një tarifë kombëtare me pakicë për njësi, e ofruesit të shërbimit roaming që aplikohet për thirrjet e kryera dhe për SMS e dërguara (nga dhe drejt rrjeteve të ndryshme publike të komunikimeve brenda të njëjtit Vend Anëtar) dhe për të dhënat e konsumuara nga një klient; në rastin kur nuk ka një tarifë kombëtare specifike unike pakice, besohet se tarifa kombëtare me pakicë është i njëjti mekanizëm tarifimi që aplikohet tek klienti për thirrjet e kryera dhe për SMS e dërguara (nga dhe drejt rrjeteve të ndryshme publike të komunikimeve brenda të njëjtit Vend Anëtar), dhe për të dhënat e konsumuara në Vendin Anëtar nga një klient;
 - s) “shitja e veçantë e shërbimeve me pakicë e të dhënave në regjimin roaming të rregulluar”, është ofrimi i këtyre shërbimeve drejtpërdrejt në një rrjet pritis nga ana e një ofruesi alternativ të shërbimit roaming.”
2. Tek neni 3, pika 6 ndryshohet si vijon:

“6. Oferta referencë e përmendur në pikën 5 duhet të jetë e detajuar dhe të përfshijë të gjithë elementët e nevojshëm për aksesin në roaming me shumicë të përmendur në pikën 3, duke dhënë një përshkrim të ofertave përkatëse për shitjen e drejtpërdrejtë me shumicë të aksesit në roaming dhe për rishitjen me shumicë të aksesit në roaming, si dhe kushtet e lidhura me to. Kjo ofertë referencë mund të përfshijë kushte për të parandaluar roamingun e përhershëm ose për të parandaluar përdorimin anormal ose abuziv të aksesit në roaming me shumicë, për qëllime të ndryshme nga ofrimi i shërbimeve të rregulluara roaming për konsumatorët gjatë udhëtimeve të tyre të rastit brenda BE-së. Nëse është e nevojshme, autoritetet kombëtare rregullatorë mund të imponojnë ndryshime në ofertat referencë, për të zbatuar detyrimet e përcaktuara në këtë nen.”

3. Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

a) Titulli ndryshohet si mëposhtë vijon:

“Shitja e veçantë e shërbimeve me pakicë të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar.”

b) Në pikën 1, paragrafi i parë shfuqizohet;

c) Pika 4 dhe 5 shfuqizohen

4. Neni 5 ndryshohet si vijon:

a) Titulli ndryshohet si më poshtë vijon:

“Zbatimi i shitjes së veçantë të shërbimeve me pakicë të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar.”

b) Pika 1 zëvendësohet si më poshtë vijon:

“1. Ofruesit kombëtarë përbushin detyrimin e shitjes së veçantë të shërbimeve me pakicë të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar, të referuara në Nenin 4, në mënyrë që klientët me roaming, të mund të përdorin shërbime të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar. Ofruesit kombëtarë duhet të përbushin të gjitha kërkesat e arsyeshme për akses në infrastrukturë dhe shërbime mbështetëse, lidhur me shitjen e veçantë të shërbimeve me pakicë të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar. Aksesi në këto infrastruktura dhe shërbime mbështetëse, të cilat kërkohen për shitjen e veçantë të shërbimeve me pakicë të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar, duke përfshirë shërbimet e identifikimi të përdoruesve, është falas dhe nuk përfshin pagesë të drejtpërdrejtë në ngarkim të klientëve në regjimin roaming.”

c) Pika 2 zëvendësohet si më poshtë vijon:

“2. Për të siguruar që shitja e veçantë e shërbimeve me pakicë të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar të zbatohet njëkohësisht dhe në mënyrë të vazhduar në të gjithë BE, Komisioni, nëpërmjet akteve zbatuese dhe pas konsultimit me BEREC-un, miraton rregulla të detajuara në lidhje me zgjidhjet teknike. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e vlerësimit të parashikuar në Nenin 6, pika 2.”

d) Tek pika 3, pjesa hyrëse zëvendësohet nga teksti i mëposhtëm:

“3. Zgjidhja teknike për zbatimin e shitjes së veçantë të shërbimeve me pakicë të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar përbush kriteret në vijim:”;

5. Shtohen nenet në vijim:

“Neni 6a

Heqja e çmimeve shtesë të roamingut me pakicë

Duke filluar nga data 15 qershor 2017, me kusht që akti ligjor që duhet të miratohet sipas propozimit të përcaktuar në Nenin 19, pika 2 do të zbatohet në këtë datë, ofruesit e shërbimeve roaming nuk aplikojnë asnjë çmim shtesë mbi çmimet kombëtare me pakicë në ngarkim të klientëve me roaming në cilindo Vend Anëtar për kryerjen dhe marrjen e thirrjeve në roaming të rregulluar, për dërgimin e mesazheve SMS në roaming të rregulluar dhe për

përdorimin e shërbimeve të të dhënave në roaming të rregulluar, përfshirë mesazhet MMS, si dhe nuk aplikojnë asnjë tarifë të përgjithshme për të mundësuar përdorimin jashtë vendit të pajisjeve fundore ose të shërbimeve, në bazë të neneve 6b dhe 6c.

Neni 6b

Përdorimi i drejtë

1. Ofruesit e roamingut mund të aplikojnë në zbatim të këtij neni dhe të akteve zbatuese sipas nenit 6d një “politikë të përdorimit të drejtë” për përdorimin e shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë, të ofruara me nivel çmimi kombëtar pakice të aplikueshëm, me qëllim parandalimin abuziv dhe jo normal të shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë nga ana e përdoruesve në roaming, si për shëmbull përdorimin nga ana e përdoruesve në roaming të këtyre shërbimeve në një Vend Anëtar të ndryshëm nga ai i ofruesit të tyre kombëtar, për qëllime të ndryshme nga ato të një udhëtimit të zakonshëm.

Një politikë e përdorimit të drejtë i jep mundësinë klientëve të ofruesit të shërbimeve roaming të konsumojnë vëllime shërbimesh roaming të rregulluara me pakicë, me çmimin kombëtar pakice të aplikueshëm që janë në përputhje me planet tarifore përkatëse.

2. Neni 6e zbatohet për shërbimet roaming të rregulluara me pakicë që i kalojnë limitet e parashikuara nga çdo politikë e përdorimit të drejtë.

Neni 6c

Qëndrueshmëria e heqjes së çmimeve shtesë të roamingut me pakicë

1. Në rrethana specifike dhe të jashtëzakonshme, për të siguruar qëndrueshmëri të modelit kombëtar të tarifimit, në rastin kur një ofrues i shërbimeve roaming nuk është në gjëndje të recuperojë koston e përgjithshme efektive dhe të parashikuara për ofrimin e shërbimeve roaming të rregulluara, sipas nenit 6a dhe 6c nga të ardhurat e përgjithshme efektive dhe të parashikuara nga ofrimi i shërbimeve të tilla, ky ofrues mund të kërkojë autorizimin për të aplikuar një çmim shtesë. Ky çmim shtesë aplikohet vetëm në masë të tillë që të shërbejë për të rikuperuar kostot e ofrimit të shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë, duke marrë parasysh tarifatat maksimale me shumicë të aplikuar.
2. Në rastin kur një ofrues i shërbimeve roaming vendos të zbatojë pikën 1 të këtij neni, i paraqet pa vonesë një kërkesë autoritetit kombëtar rregullator duke i siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm sipas akteve zbatuese të nenit 6d. Çdo 12 muaj ofruesi i shërbimeve roaming i përditëson këto informacione dhe ja paraqet atë autoritetit kombëtar rregullator.
3. Në momentin e marrjes së kërkesës, sipas pikës 2, autoriteti kombëtar rregullator vlerëson nëse ofruesi i shërbimeve roaming e ka përcaktuar që nuk është në gjëndje të recuperojë kostot, sipas pikës 1, duke patur si pasojë kompromentimin e qëndrueshmërisë së modelit të tij kombëtar të tarifimit. Vlerësimi i qëndrueshmërisë së modelit kombëtar të tarifimit bazohet mbi faktorë objektivë të veçantë për ofruesin e shërbimeve roaming, duke përfshirë ndryshimet objektive midis ofruesve të shërbimeve roaming në Vendin Anëtar në fjalë dhe nivelin e çmimeve dhe të të ardhurave kombëtare. Autoriteti kombëtar rregullator do të autorizojë çmimet shtesë nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 dhe në këtë pikë.
4. Brenda një muaj nga marrja e kërkesës sipas pikës 2, autoriteti kombëtar rregullator autorizon çmimin shtesë, përveç rastit kur kërkesa është e pabazë ose nuk ka informacion të mjaftueshëm. Në rastin kur autoriteti kombëtar rregullator konsideron se kërkesa është e pabazë ose konsideron të pamjaftueshme informacionet e dhëna, merr një vendim

përfundimtar brenda një afati dy mujor, pasi i ka dhënë ofruesit të shërbimeve roaming mundësinë për tu dëgjuar, me qëllim autorizimin, modifikimin ose refuzimin e çmimit shtesë.

Neni 6d

Zbatimi i politikës së përdorimit të drejtë dhe i qëndrueshmërisë së heqjes së çmimeve shtesë me pakicë të roamingut

1. Brenda datës 15 dhjetor 2016, për të garantuar aplikimin korrekt të dispozitave të neneve 6b dhe 6c, Komisioni, pas konsultimeve me BEREC, miraton aktet zbatuese që përcaktojnë rregullat e detajuara në lidhje me zbatimin e politikës së përdorimit të drejtë dhe të metodologjisë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së heqjes së çmimit shtesë me pakicë të roamingut, si dhe për kërkesën që duhet të paraqesë ofruesi i shërbimeve roaming për të bërë këtë vlerësim. Këto akte zbatuese miratohen sipas procedurave të vlerësimit të parashikuara në nenin 6, pika 2.
2. Për sa i përket nenit 6b në miratimin e akteve zbatuese që përcaktojnë rregullat e detajuara në lidhje me aplikimin e politikës së përdorimit të drejtë, Komisioni merr parasysh si më poshtë:
 - a) Zhvillimin e çmimeve dhe modeleve të konsumit në Vendet Anëtare;
 - b) Gradën e konvergencës së niveleve të çmimeve kombëtare të BE-së;
 - c) Modelet e udhëtimeve në BE-së;
 - d) Risqet e mundshme në lidhje me shtrembërimin e konkurrencës dhe të nxitjeve të investimeve në tregjet kombëtare dhe ato të vizituara.
3. Për sa i përket nenit 6c, në miratimin e akteve zbatuese që përcaktojnë rregullat e detajuara në lidhje me metodologjinë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së heqjes së çmimeve shtesë me pakicë të roamingut, Komisioni bazohet në elementët në vijim:
 - a) Përcaktimi i kostove të përgjithshme efektive dhe të parashikuara për ofrimin e shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë bazuar në tarifatat efektive me shumicë të shërbimeve roaming për trafikun e pabalancuar dhe për një vlerë të arsyeshme të kostove të përbashkëta të nevojshme për ofrimin e shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë;
 - b) Përcaktimi i të ardhurave të përgjithshme efektive dhe të parashikuara nga ofrimi i shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë;
 - c) Konsumi i shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë dhe konsumi kombëtar nga ana e klientëve të ofruesit të shërbimeve roaming;
 - d) Niveli i konkurrencës, çmimeve dhe të ardhurave në tregun kombëtar, dhe çfarëdo rreziku të mundshëm që shërbimet roaming me çmime kombëtare shitjeje me pakicë mund të ndikojnë në zhvillimin e këtyre çmimeve.
4. Komisioni rishikon në mënyrë periodike aktet zbatuese të miratuara sipas pikës 1, sipas zhvillimeve të tregut.
5. Autoriteti kombëtar rregullator kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikës së përdorimit të drejtë dhe të masave mbi qëndrueshmërinë e heqjes së çmimeve shtesë me pakicë të roamingut, duke mbajtur në konsideratë faktorët objektivë, sipas specifikave të Vendit Anëtar të interesuar dhe ndryshimet relevante objektive midis ofruesve të shërbimeve roaming. Pvarësisht procedurës së përmendur në nenin 6c, pika 3, autoriteti kombëtar rregullator fillon zbatimin sa më parë të dispozitave të neneve 6b dhe 6c dhe aktet të miratuara në zbatim të pikës 1 të këtij neni. Autoriteti kombëtar rregullator mundet që në çdo moment ti kërkojë ofruesit të shërbimeve roaming ndryshimin ose pezullimin e çmimit shtesë, nëse ky nuk është në përputhje me nenin 6b ose 6c. Autoriteti

kombëtar rregullator njofton çdo vit Komisionin rreth zbatimit të neneve 6b dhe 6c, dhe të nenit aktual.

Neni 6e

Ofrimi i shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë

1. Pavarësisht nga paragrafi i dytë, kur ofruesi i shërbimeve roaming aplikon një çmim shtesë për përdorimin e shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë të cilat kalojnë çdo limit të parashikuar nga politika e përdorimit të drejtë, duhet të përmbushë kërkesat në vijim (me çmim pa TVSH):
 - a) çdo çmim shtesë që aplikohet për thirrje roaming të rregulluara, SMS roaming të rregulluara dhe shërbime të të dhënave roaming të rregulluara nuk duhet të tejkalojë çmimet maksimale të shitjes me shumicë të përcaktuara në pikën 2 të nenit 7, të pikës 1 të nenit 9 dhe të pikës 1 të nenit 12;
 - b) shumat e çmimit kombëtar me pakicë dhe e çmimeve shtesë të aplikuara për thirrjet roaming të rregulluara, për SMS roaming të rregulluara ose për shërbime të të dhënave roaming të rregulluara nuk e tejkalojnë shumën, respektivisht, 0,19 Euro për minutë, 0,06 Euro për SMS dhe 0,20 Euro për megabyte të përdorur;
 - c) çmimet shtesë të aplikuara për marrjen e thirrjeve në regjimin roaming të rregulluar nuk tejkalojnë mesataren e ponderuar të tarifave maksimale të terminimit të telefonatave mobile në të gjithë BE-në të përcaktuara në përputhje me pikën 2.

Ofruesit e shërbimeve roaming nuk aplikojnë asnjë çmim shtesë për marrjen e një SMS në regjimin roaming të rregulluar ose për marrjen e një mesazhi zanor në regjimin roaming. Kjo nuk pengon aplikimin e tarifave të tjera, të tilla si ato për dëgjimin e këtyre mesazheve.

Ofruesit e shërbimeve roaming aplikojnë një tarifë për sekondë të përlllogaritur, për kryerjen dhe marrjen e telefonatave në regjimin roaming. Ofruesit e shërbimeve roaming mund të aplikojnë për telefonatat e kryera një periudhë fillestare minimale tarifimi jo më të madhe se 30 sekonda. Ofruesit e shërbimeve roaming i kreditojnë klientët e tyre, në bazë të kilobyte, për ofrimin e shërbimeve të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar, me përjashtim të mesazheve MMS, të cilat mund të tarifohen për njësi. Në këtë rast, çmimi me pakicë që një ofrues i shërbimeve roaming mund të aplikojë për klientët e tij për marrjen ose dërgimin e një mesazhi MMS nuk kalon tarifën maksimale me pakicë për shërbimet e të dhënave në regjimin roaming të përcaktuar në pikën e parë.

Gjatë periudhës së përmendur në pikën 1 të nenit 6f, kjo pikë nuk përjashton mundësinë e ofrimit për klientët e shërbimeve roaming, të një tarife ditore ose çdo lloj tjetër tarife fikse periodike, një sasi të caktuar volumi konsumi për shërbimet roaming të rregulluara, me kusht që konsumimi i të tërë sasisë së këtij volumi të sjellë një çmim unik për telefonatat e kryera në regjimin roaming të rregulluar, telefonatat e marra, SMS e dërguara dhe shërbimet e të dhënave në regjimin roaming, të cilat nuk tejkalojnë çmimin kombëtar respektiv me pakicë si dhe çmimin shtesë të përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike.

2. Brenda datës 31 dhjetor 2015 Komisioni, pas konsultimit me BEREC dhe duke marrë parasysh paragrafin e dytë të kësaj pike, miraton aktet zbatuese të cilat caktojnë mesataren e ponderuar të tarifave maksimale për terminimin e thirrjeve të cituara në

shkronjën c), paragrafi i parë i pikës 1. Komisioni i vlerëson çdo vit këto akte. Këto akte miratohen sipas procedurave të përcaktuara në pikën 2 të nenit 6.

Mesatarja e ponderuar e tarifave maksimale e thirrjeve bazohet në kriteret në vijim:

- a) Nivelin maksimal të tarifave të terminimit të thirrjeve të caktuara në treg, për terminimin e thirrjeve zanore me shumicë mbi rrjetet mobile të veçanta, nga autoriteteve rregullatore në përputhje me nenet 7 dhe 16 të direktivës kuadër dhe nenit 13 të direktivës së Aksesit, dhe
 - b) Numrit total abonentëve në Vendet Anëtare.
3. Ofruesit e shërbimeve roaming mund të ofrojnë dhe klientët në regjimin roaming mund të zgjedhin me dëshirë një tarifë roaming të ndryshme nga ato të paraqitura në nenet 6a, 6b dhe 6c, dhe në pikën 1 të këtij neni, falë së cilës klientët në regjimin roaming përfitojnë, për shërbimet roaming të rregulluara, një tarifë të ndryshme nga ajo e cila mund të aplikohet në të kundërt. Ofruesi i shërbimeve roaming i kujton këtyre klientëve avantazhet nga të cilat po heqin dorë.

Pavarësisht nga paragrafi i parë, ofruesit e shërbimeve roaming aplikojnë automatikisht një tarifë në përputhje me nenet 6a dhe 6b, dhe pikës 1 të këtij neni, për të gjithë klientët në regjimin roaming, të rinj dhe ekzistues.

Çdo klient në regjimin roaming mund të kërkojë në çdo moment të kalojë në një tarifë të fiksuar sipas neneve 6a, 6b, 6c dhe pikës 1 të këtij neni ose të heqin dorë nga kjo tarifë. Kur klientët zgjedhin të heqin dorë ose të kthehen tek një tarifë e fiksuar sipas neneve 6a, 6b, 6c dhe pikës 1 të këtij neni, çdo ndryshim ndodh brenda një dite pune nga marrja e kërkesës, është falas dhe nuk parashikon kushte ose kufizime të elementëve të abonimit të ndryshme nga ato të shërbimit roaming. Ofruesit e shërbimeve roaming mund ta vonojnë këtë ndryshim sa kohë që tarifa e mëparshme e roamingut nuk ka qënë në fuqi për një periudhë të caktuar minimale, e cila nuk i kalon dy muajt.

4. Ofruesit e shërbimeve roaming marrin masa me qëllim që kontratat që përfshijnë çdo lloj shërbimi roaming të rregulluara me pakicë të saktësojnë karakteristikat kryesore të këtij shërbimi të ofruar, ndër të cilat, në veçanti:
 - a) Planin ose planet tarifore specifike dhe, për çdo plan tarifor, llojet e shërbimeve të ofruara, duke përfshirë volumin e komunikimeve;
 - b) Kufizimet e mundshme të caktuara në lidhje me konsumimin e shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë të ofruara në nivelin e çmimit kombëtar me pakicë të aplikuar, në veçanti informacion të përmbledhur mbi mënyrat e aplikimit të politikës së përdorimit të drejtë me referencë tek parimet tarifore, për volum ose për parametra të tjerë të shërbimeve roaming të rregulluara me pakicë të ofruara.

Informacionet e mësipërme bëhen publike nga ana e ofruesve të shërbimeve roaming.

Neni 6f

Çmime shtesë tranzitore me pakicë për shërbimet roaming

1. Nga data 30 prill 2016 deri më 14 qershor 2017, ofruesit e shërbimeve roaming mund të aplikojnë një çmim shtesë mbi çmimin kombëtar me pakicë për ofrimin e shërbimeve roaming të rregulluara.
2. Në periudhën e cituar në pikën 1, neni 6e zbatohet *mutatis mutandis* (me ndryshimet e nevojshme);

6) Nenet 8, 10 dhe 13 shfuqizohen;

7) Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

a) Në pikën 1, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Informacionet bazike të personalizuara mbi tarifatat shprehen në valutën e faturës origjinale të lëshuar nga ofruesi kombëtar i klientit dhe përfshijnë informacione mbi:

- a) Çdo politikë e përdorimit të drejtë së cilës i nënshtrohet klienti në regjimin roaming brenda BE-së dhe çmimeve shtesë që kalojnë limitet e parashikuara nga kjo politikë; dhe
- b) Çdo çmimi shtesë të aplikuar në zbatim të nenit 6c;

b) Tek pika 1, paragrafi i gjashtë zëvendësohet si më poshtë:

“Paragrafi i parë, i dytë, i katërt dhe i pestë, me përjashtim të referencës së politikës së përdorimit të drejtë dhe të çmimeve shtesë të aplikuara në zbatim të nenit 6c, aplikohen edhe për shërbimet e thirrjeve zanore dhe SMS në regjimin roaming të përdorur nga klientët e roaming në udhëtim jashtë BE-së dhe të ofruar nga një ofrues i shërbimeve roaming”;

c) Shtohet pika në vijim:

“2a. Ofruesi i shërbimeve roaming dërgon një njoftim tek klienti kur ky i fundit ka konsumuar të tërë volumin e aplikueshëm sipas përdorimit të drejtë për shërbimet e thirrjeve zanore, ose të SMS-ve, në regjimin roaming të rregulluar, ose kur ka arritur limit e përdorimit të aplikuar në zbatim të nenit 6c. Ky njoftim tregon çmimin shtesë që do të aplikohet në rastin e një konsumi shtesë nga ana e klientit, për shërbimet e thirrjeve zanore ose të SMS-ve. Çdo klient ka të drejtë të kërkojë që ofruesi i shërbimeve roaming të ndërpresë dërgimin e këtyre njoftimeve dhe t'i kërkojë ofruesit, në çdo moment dhe pa tarifa shtesë, rivendosjen e këtij shërbimi.”;

d) Pika 3 zëvendësohet si më poshtë:

“3. Ofruesit e shërbimeve roaming i ofrojnë të gjithë klientëve informacione të detajuara mbi tarifatat e shërbimeve roaming në momentin e nënshkrimit të abonimit. Këta të fundit i përditësojnë menjëherë klientët në regjimin roaming mbi tarifatat e aplikueshme dhe çdo ndryshim të tyre.

Në vijim, ofruesit e shërbimeve roaming dërgojnë, me intervale të arsyeshme, një njoftim për të gjithë klientët që kanë zgjedhur një tjetër tarifë.”

8) Neni 15 ndryshohet si vijon:

a) Pika 2 zëvendësohet si më poshtë:

“2. Një mesazh automatik i dërguar nga ofruesi i shërbimeve roaming informon klientin në regjimin roaming për faktin që ky i fundit po përdor shërbime të dhënash në regjimin roaming të rregulluar dhe jep informacion mbi tarifatat të personalizuara (në valutën e faturës së lëshuar nga ofruesi kombëtar i klientit), të aplikueshme për ofrimin e shërbimeve të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar për klientin që përdor roaming në Vendin Anëtar në fjalë, me përjashtim të rastit kur klienti i ka komunikuar ofruesit që nuk e dëshiron këtë informacion.

Ky informacion tarifar i personalizuar përfshin informacione mbi:

- a) Çdo politikë të përdorimit të drejtë së cilës i nënshtrohet klienti brenda BE-së dhe çmimet shtesë që aplikohen mbi limitet e parashikuara nga kjo politikë e përdorimit të drejtë; dhe
- b) Çdo çmim shtesë të aplikuar sipas nenit 6c.

Informacionet dërgohen në aparatën mobile të klientit në regjimin roaming, psh nëpërmjet SMS, një mesazhi poste elektronike ose një dritare pop-up në apart, çdo herë që klienti në

regjimin roaming hyn në një Vend Anëtar të ndryshëm nga ai i ofruesit kombëtar dhe fillon të përdorë, për herë të parë, një shërbim në regjim roaming në këtë Vend Anëtar. Informacioni jepet pa tarifë shtesë, me mjete të përshtatshme për të lehtësuar marrjen dhe kuptimin.

Një klient që i komunikuar ofruesit të shërbimeve roaming që nuk dëshiron të marrë informacione automatike mbi tarifat ka të drejtën që, në çdo moment dhe pa tarifë shtesë, t'i kërkojë ofruesit ta rivendosë këtë shërbim.”;

b) Shtohet pika në vijim:

“2a. Ofruesi i shërbimeve roaming dërgon një njoftim tek klienti kur ky i fundit ka konsumuar të tërë volumin e aplikueshëm sipas përdorimit të drejtë për shërbimet e të dhënave, në regjimin roaming të rregulluar, ose kur ka arritur limit e përdorimit të aplikuar në zbatim të nenit 6c. Ky njoftim tregon çmimin shtesë që do të aplikohet në rastin e një konsumi shtesë nga ana e klientit, për shërbimet e të dhënave në regjimin roaming të rregulluar. Çdo klient ka të drejtë të kërkojë që ofruesi i shërbimeve roaming të ndërpresë dërgimin e këtyre njoftimeve dhe t'i kërkojë ofruesit, në çdo moment dhe pa tarifa shtesë, rivendosjen e këtij shërbimi..”

c) Pika 3 zëvendësohet si më poshtë:

“3. Çdo ofrues i jep mundësinë të gjithë klientëve të tij në regjimin roaming zgjedhin lirisht dhe pa tarifë shtesë një shërbim që ofron në mënyrë të shpejtë informacione mbi konsumin të shprehur në volum ose në valutën në të cilën klienti paguan tarifat për shërbimet e të dhënave në regjimin roaming të rregulluar dhe që garanton se, pa konsensusin e shprehur nga klienti, shpenzimi total për shërbimet e të dhënave në regjimin roaming të rregulluar për një periudhë kohore, përjashtuar MMS-të e faturuara për njësi, të mos tejkalojë një limit të përcaktuar financiar.”;

d) Në pikën 6, paragrafi i parë zëvendësohet si më poshtë:

“6. Ky nen, me përjashtim të pikës 5, të paragrafit të parë të pikës 2 dhe të paragrafit 2a dhe duke përjashtuar paragrafin e dytë dhe të tretë të kësaj pike, aplikohet dhe për shërbime të të dhënave në regjimin roaming të përdorur nga klientë në regjim roaming që udhëtojnë jashtë BE-së dhe që ofrohen nga një ofrues i këtyre shërbimeve.”;

9. Neni 16 modifikohet si më poshtë:

a) Pikës 1 i shtohet paragrafi i më poshtëm:

“Autoritetet kombëtare rregullatore kontrollojnë dhe monitorojnë nga afër zbatimin nga ana e ofruesve të shërbimeve roaming të neneve 6b dhe 6c dhe pikës 3 të nenit 6e.”;

b) Pika 2 zëvendësohet si më poshtë:

“2. Autoritetet kombëtare rregullatore i garantojnë publikut informacione të përditësuara mbi zbatimin e kësaj rregulloreje, në veçanti të neneve 6a, 6b, 6c quater, 6 sexies, 7, 9 dhe 12, me qëllim që palët e interesuara të kenë akses të lehtësuar.”;

10. Neni 19 zëvendësohet si vijon:

“Neni 19

Rivlerësimi

1. Brenda datës 29 nëntor 2015, Komisioni kryen një rivlerësim të tregut të roamingut me shumicë me qëllim vlerësimin e masave të nevojshme për të lejuar heqjen e çmimeve shtesë

me pakicë të roamingut brenda datës 15 qershor 2017. Komisioni rivlerëson, ndër të tjera, nivelin e konkurrencës në tregjet kombëtare të shumicës dhe, në veçanti, vlerëson nivelin e shpenzimeve me shumicë të kryera dhe tarifave me shumicë të aplikuara, si dhe të situatës së konkurrueshmërisë të operatorëve me mbulim gjeografik të limituar, përfshirë dhe efektet e marrëveshjeve tregtare mbi konkurrencën, si dhe aftësinë e operatorëve për të përfituar nga ekonomitë e shkallës. Komisioni vlerëson, gjithashtu, zhvillimet e konkurrencës në tregjet e roamingut me pakicë dhe rreziqet e mundshme nga shtrembërimi i konkurrencës, si dhe të masave nxitëse të investimeve në tregjet kombëtare dhe ato të vizituara. Në vlerësimin e masave të nevojshme për heqjen e çmimeve shtesë me pakicë të roamingut, komisioni merr parasysh nevojën për të siguruar që operatorët të një rrjeti pritës të jenë në gjendje të rikuperojnë të gjithë kostot e ofrimit të shërbimeve roaming me shumicë, duke përfshirë kostot e përbashkëta. Komisioni merr parasysh edhe nevojën për të ndaluar roamingun permanent ose të parandalojë përdorimin jo normal ose abuziv të aksesit me shumicë në shërbimet roaming për qëllime të ndryshme nga ato të ofrimit të shërbimeve roaming të rregulluara për klientët gjatë udhëtimeve të tyre të rastësishme brenda BE-së.

2. Brenda datës 15 qershor 2016 Komisioni i paraqet Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport mbi rezultatet e rivlerësimit të përmendur në pikën 1.
Ky raport shoqërohet me një propozim ligjor, i paraprirë nga një konsultim publik, me qëllim modifikimin e tarifave me shumicë për shërbimet roaming të rregulluar të përcaktuara në këtë rregullore ose për të ofruar një zgjidhje tjetër për të trajtuar çështjet e identifikuar në nivel tregu me shumicë në mënyrë që të hiqen çmimet shtesë me pakicë të roamingut me pakicë, brenda datës 15 qershor 2017.
3. Gjithashtu, çdo dy vjet pas prezantimit të raportit të përmendur në pikën 2, Komisioni i paraqet një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Çdo raport përmban, ndër të tjera, një vlerësim:
 - a) Të disponibilitetit dhe të cilësisë së shërbimeve, ndër të cilat ato që paraqesin një alternativë për shërbimet e telefonatave zanore, SMS-ve dhe të të dhënave roaming të rregulluara me pakicë, sidomos në dritën e zhvillimeve teknologjike;
 - b) Të nivelit të konkurrencës në tregun e roamingut me shumicë dhe me pakicë, në veçanti të situatës së konkurrencës së operatorëve të vegjël, të pavarur ose ata të cilët sapo kanë nisur aktivitetin, ndër të tjera të efekteve konkurruese të marrëveshjeve tregtare dhe të shkallës së ndërlidhjes midis operatorëve;
 - c) Të shkallës në të cilën zbatimi i masave strukturore të parashikuara në nenet 3 dhe 4 ka dhënë rezultate për zhvillimin e konkurrencës në tregun e brendshëm për shërbimet roaming të rregulluara.
4. Me qëllim vlerësimin e zhvillimit të konkurrencës në tregjet e roamingut brenda BE-së, BEREC mbledh periodikisht nga autoritetet kombëtare rregullatore të dhëna mbi zhvillimet e tarifave me pakicë dhe shumicë për shërbimet e thirrjeve zanore, SMS-ve dhe të të dhënave në regjimin roaming të rregulluar. Këto të dhëna transmetohen në Komision të paktën dy herë në vit.

Mbi bazën e të dhënave të mbledhura, BEREC raporton rregullisht mbi zhvillimet e çmimeve dhe të modeleve të konsumit në Vendet Anëtare si për shërbimet kombëtare, ashtu edhe për shërbimet roaming, si dhe për zhvillimet e ecurisë së tarifave efektive të roamingut me shumicë për diferencën në trafik midis ofruesve të shërbimeve roaming.

BEREC mbledh, gjithashtu, çdo vit nga autoritetet kombëtare rregullatore informacione mbi transparencën dhe krahasueshmërinë e tarifave të ndryshme të ofruara nga operatorët tek klientët e tyre. Këto të dhëna dhe përfundime bëhen publike nga Komisioni.

Neni 8

Ndryshimi i direktivës 2002/22/KE

Në nenin 1 të direktivës 2002/22/KE, pika 3 ndryshohet si në vijim:

“3. Masat kombëtare për aksesin ose për përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike nga ana e përdoruesve fundor respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, përfshirë ato në lidhje me jetën private dhe procesit të drejtë, sipas përcaktimeve të nenit 6 të Konventës Evropiane për Ruajtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore.”.

Neni 9

Klauzola e rishikimit

Brenda datës 30 prill 2019, dhe në vijim çdo katër vjet, Komisioni rivlerëson nenet 3, 4, 5 dhe 6 dhe paraqet një relacion në Parlamentin Evropian dhe në Këshill, së bashku, nëse është e nevojshme, me propozimet e nevojshme për modifikimin e kësaj rregulloreje.

Neni 10

Hyrja në fuqi dhe dispozita tranzitore

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e tretë pas publikimit në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian*.
2. Kjo e fundit zbatohet duke filluar nga 30 prilli 2016, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:
 - a) Në rastin kur akti ligjor që duhet të miratohet sipas propozimit të cituar në pikën 2 të nenit 19 të rregullores (BE) nr. 531/2012 të fillojë zbatimin më 15 qershor 2017, pikën 5 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, përsa i përket neneve nga *6 bis* deri më *6 quinquies* të rregullores (BE) nr. 531/2012, shkronjave nga a) deri në c) të pikës 7 të nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe shkronjave a), b) dhe d) të pikës 8 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, aplikohen duke filluar nga kjo datë.
Kur ky akt ligjor nuk fillon zbatimin më datë 15 qershor 2017, vazhdon të zbatohet pika 5 e nenit 7 të kësaj rregulloreje, përsa i përket nenit *6 septies* të rregullores (BE) nr. 531/2012 deri në datën në të cilën ky akt ligjor bëhet i zbatueshëm.
Kur ky akt ligjor bëhet i zbatueshëm pas datës 15 qershor 2017, pika 5 e nenit 7 të kësaj rregulloreje, përsa i përket neneve nga *6 bis* deri më *6 quinquies* të rregullores (BE) nr. 531/2012, shkronjat nga a) deri më c) të pikës 7 të nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe shkronjave a), b) dhe d) të pikës 8 të nenit 7, zbatohen duke filluar nga data e aplikimit të aktit ligjor të cituar.
 - b) Dhënia e kompetencave zbatuese për Komisionin sipas shkronjës c) të pikës 4 të nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe të pikës 5 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, përsa i përket nenit *6 quinquies* dhe pikës 2 të nenit *6 sexes*, të rregullores (BE) nr. 531/2012, zbatohen duke filluar nga data 29 nëntor 2015;
 - c) Pika 3 e nenit 5 zbatohet duke filluar nga data 29 nëntor 2015;
 - d) Pika 10 e nenit 7 e kësaj rregulloreje zbatohet duke filluar nga data 29 nëntor 2015.
3. Vendet Anëtare mund të mbajnë deri më datë 31 dhjetor 2016 masat kombëtare, duke përfshirë regjimet e vetërregullimit, në fuqi para datës 29 nëntor 2015 dhe që nuk janë në përputhje me pikat 2 ose 3 të nenit 3. Këto Vende Anëtare ja komunikojnë Komisionit këto masa brenda datës 30 prill 2016.
4. Dispozitat e rregullores zbatuese (BE) nr. 1203/2012 të Komisionit, të lidhura me modalitetet teknike për realizimin aksesit në shërbimet lokale të të dhënave roaming në rrjetin mikpritës,

vazhdojnë të zbatohen me qëllim shitjen e veçuar të shërbimeve të të dhënave me pakicë në regjimin roaming të rregulluar deri në aplikimin e aktit zbatues të cituar në shkronjën c) të pikës 4 të nenit 7 të kësaj rregulloreje.